

“UDHËTIM ME JONAN”



Kampi ditor për fëmijë

Lojra, argëtim, adhurim, fjalë nga Bibla, shoqëri e mirë, ushqim i shijshëm, dhe pse jo pjesë e udhëtimit të jashtëzakonshëm të Jonës...

“Udhëtim me Jonan”

A dëshiron edhe ti që këtë verë, të kalosh një kohë të mirë me lojra, aktivitete, bashkësi me Zotin dhe miqësi me fëmijët e tjerë?

Po...

Atëherë nxito të regjistrohesh në kampin e fëmijëve që organizon Nehemiah Gateway Albania, vetëm për nxënësit e shkollës Nehemia në ambientet e saj në Buçimas.

Datat e kampit:

10 – 14 gusht

Mosha: 7 – 9 vjeç

(të këtë mbaruar klasën e I, II, III)

Kampi fillon të hënën më datë 10 gusht dhe përfundon të premten më datë 14 gusht.

Ky kamp kushton 1500 lekë për një javë të cilat duhet t'i paguani përmes bankës (për detajet shiko në vazhdim).

Materiale për t`u marrë me vete:

Çdo ditë fëmijët duhet të kenë me vete:

- Mjetetet e punëdores (gërshërë, lapsa me ngjyrë, prefse lapsash, ngjithës, laps të zi, gomë. (duke qenë se sipas ligjit nuk është e lejuar ndarja e materialeve menduam që kjo do ishte rruga më e mirë.

- Maska, doreza dhe disinfektues për duart.

- Kapele për diell

- Bidon me ujë

- Një bluzë pambuku me mëngë të shkurtra nëse dërsit gjatë lojrave.

Informacione të përgjithshme për kampin:

- Në kamp do të ketë adhurim, mësim nga Bibla, diskutime në grup, kohë argëtuese me lojra në natyrë, ekskursion në Volorekë, kampionate, lojra në bregun e liqenit, krijimtari (punëdores, drama) etj.

- Ky kamp është një kamp ditor. Fëmijët do të mbledhen në mëngjes sipas stacioneve përkatëse. Ata duhet të kenë ngrënë në shtëpi mëngjesin, ngrënia e drekës është e përfshirë në çmimin e kampit.

- Për shkak të Pandemisë kampi këtë vit do kufizohet me pjesëmarrjen e vetëm 50 fëmijëve dhe këta duhet të jenë nxënës të shkollës Nehemia.

- Kampi ditor është vetëm për moshën 7 – 9 vjeç. Ju lutem mos sillni fëmijë nën dhe mbi këtë moshë. Nuk do ketë asnjë rregjistrim ditën e parë të kampit.

- Rregjistrimi i kampistit do bëhet online. Plotësimi i aplikimit online do të thotë gjithashtu që ju jeni dakort që fëmija të marri pjesë në aktivitet, të zbatojë rregulloren për shkak të COVID 19, sipas të gjitha udhëzimeve.

Informacione mbi transportin:

- Ditën e parë secili prej prindërve duhet të shoqërojë vetë fëmijën por deri në ambientet e jashtme të Ng Albani në orën 9.00.

- Autobuzi ditën e parë në mbasditë dhe çdo ditë tjetër do të kalojë në këto stacione: (Starovë, Gjolla SHPK, Karburanti i shtetit, Kinezi, Turizmi, Lumi, Rruga e Spitalit, Kinezi)

- Në mëngjes Autobuzat do të jetë tek Kinezi në orën 8.50, kurse pasditë në orën 15.40.

- Ju lutem udhëzoheni fëmijën qartë se në cilin stacion duhet të zbresë. Ju duhet t'i prisni fëmijët në stacionet përkatëse sipas orarit të përcaktuar.

Udhëzime për shëndetin:

- Është shumë e rëndësishme që ju të na informoni nëse fëmija juaj është alergjik nga diçka. Kjo është për të mbrojtur fëmijën tuaj.

- Nëse fëmija juaj është duke marrë mjekim ju lutem lajmëroni përgjegjës/en e fëmijës suaj, që fëmija ka ilaçe me vete, kur duhet t'i pijë ilaçet dhe sa ilaçe ju i keni dhënë me vete.

- Nëse fëmija juaj ka problem me ushqimin (është alergjik, jo tolerant) ju lutem na lajmëroni gjithashtu paraprakisht dhe jo ditën e parë të kampit).

- Për shkak të gjëndjes së Pandemisë, na lajmëroni nëse fëmija ka pasur temperaturë apo ka kontaktuar persona të sëmurë me COVID 19.

Rregjistrimi dhe pagesa:

- Për të regjistruar fëmijën ju duhet të mbushni aplikimin online dhe të bëni pagesën përmes bankës. Konfirmimin e pagesës ju lutemi ta dërgoni me foto tek numri i Whatsapp të drejtueses së kampit ose mësueses kujdestare. Pagesa për një javë në kamp është 1500 lekë.


- Pagesa mund të bëhet në një nga numrat e llogarisë.

Procredit Bank në numrin e llogarisë IBAN AL22209415070000550024220201

Raiffeisen Bank në numrin e llogarisë IBAN AL37202420040000000002590172 dhe

Societe Generale Albania në numrin e llogarisë IBAN AL22213420110000000001574148

NEHEMIAH
GATEWAY
ALBANIA



Për çdo pyetje ju mund të kontaktoni nga ora 08:00 – 17:00:

Anila Sinani (drejtuesja e kampit)

Cel: 0696037248

Email: anila.sinani@ng.team

Nehemiah Gateway Albania office

Tel: 086820004

Email: office@ng.team